



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 14/08/2019

Ref.: 1448/19A

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 76-të të mbajtur më 25.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e Universitetit të Prishtinës nr. 1274/19H, datë 18.07.19 për rritje të kuotave për programet e studimit:

- Mjekësi e Përgjithshme Dr. Med 360 ECTS
- Infermieri, BSc 180 ECTS

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Prishtinës ka parashtruar kërkesë për rritje të kuotës së numrit të studentëve për programet Mjekësi e Përgjithshme Dr. Med 360 ECTS nga 150 student sa është numri i lejuar për regjistrim për vit akademik në 225 student; dhe Infermieri BSc 180 ECTS, nga 50 student sa është numri i lejuar për regjistrim për vit akademik në 109 student.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka analizuar kërkesën për rritje të kuotave për regjistrim të studentëve. Votimi për këtë pikë të rendit të ditës ka qenë 4 vota PËR rritje të kuotave dhe 3 vota KUNDËR.

Ligji për Arsimin e Lartë, Neni 4, pika 4.6, Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e IAL-ve, Neni 4, pika 2.3, dhe Rregullorja e KShC-së, Neni 12, pika 1, përcaktojnë se KShC i merr vendimet e saj me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve (50% + 1). Rrjedhimisht propozimi për rritjen e kuotave për regjistrim të studentëve nuk ka marrë numrin e mjaftueshëm të votave të përcaktuar me legjislacion.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë